

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED), Instituti për Studime të Avancuara (GAP), Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ)

20 shtator 2011, Prishtinë

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### **Mangësitë e Termeve të Referencës së Bankës Botërore për punën e Panelit të ekspertëve që do të vlerësoi projektin e termocentralit “Kosova e re”**

Para disa javësh, Banka Botërore (BB) në uebfaqen e saj për Kosovën publikoi emrat e tre ekspertëve të përzgjedhur për të vlerësuar përshtatshmërinë e projektit të propozuar për termocentralin e ri në Kosovë me kriteret e përmbledhura në Kornizën Strategjike të Zhvillimit dhe Ndryshimeve Klimatike (SFDC) të Bankës Botërore. Në të njëjtën kohë u publikuan edhe Termet e Referencës (ToR) për punën e këtij Paneli. KIPRED, GAP dhe FIQ kanë analizuar për së afërmi këto terme dhe kanë identifikuar shumë mangësi dhe informata të pasakta e të paplota në këtë dokument. Të gjitha këto mangësi janë të përmbledhura në nëntë pikat në vijim:

1. **Qëllimi i punës së Panelit dhe kriteret që kanë të bëjnë me klimën** - ToR dështon të ofroj një sqarim fundamental mbi qëllimet përfundimtare të Panelit të Ekspertëve dhe të parimeve udhëzuese të cilat BB i ka përcaktuar në formë kriteresh për projektet e bazuara në qymyr. Qëllimi përfundimtar i kriterëve klimatike është që BB të realizoj projektet më të mira nga të cilat përfitojnë grupet e varfra të popullatës, ato që sigurojnë projekte të pastërta (kjo nuk nënkupton vetëm projekte më të pastra se ato ekzistuese dhe ato të vjetruara), si dhe për të siguruar që opsionet e bazuara në qymyr zbatohen vetëm në ato raste kur nuk ka zgjidhje tjera.
2. **Vëllimi i punëve** – Vëllimi i punëve që është përcaktuar në ToR nuk i jep mundësinë Panelit që të vendosë të kundërshtoj këtë projekt për mos-përputhje me kriteret klimatike (gjegjësisht gjashtë kriteret e SFDC). Për më tepër, dokumenti lë të vetëkuptohet që nëse ka mangësi në këtë projekt, Paneli duhet vetëm të nënvizoj që duhet një zgjidhje “praktike” për problemet a hasura dhe jo të kundërshtoj projektin.
3. **Saktësia e profilit energjetik të Kosovës** – ToR dështojnë të ofrojnë një pasqyrë të saktë të nevojës për energji në Kosovë. Në mënyrë që të përcaktohet teknologjia e duhur për një projekt energjetik, është qenësore që BB të ofroj një pasqyrë të llojit të kërkesës për energji në vend, ku përfshihet energjia për kohë piku dhe jashtë pikut, ajo për ngrohje, etj. Siç duhet të merren

---

parasysh projektet tjera që duhet të ndihmojnë në përmirësimin e situatës, e që do të duhej të rezultonin nga përmirësimi i sistemit energjetik në vend dhe masat e efijencës së energjisë.

4. **Konsumatorët** - ToR dëshon të përcaktoj qartazi përputhshmërinë e vet me qëllimet e kriterit numër 1 të SFDC-së, i cili përkufizohet me "përmirësimin e dukshëm të qasjes në energji dhe/apo ndërlihdjen e saj me përmirësimin e sektorit ekonomik dhe zvogëlimin e varfërisë". Për më tepër, dokumentet e BB-së që rrjedhin nga projekti i saj për asistencë Kosovës përkufizojnë qëllimin e projektit për të zhvilluar projektet energjetike nga linjiti për qëllime të eksportit. Vendimi për të zhvilluar projektin e linjtit është marrur nga Banka botërore, UNMIK-u dhe donatorë tjerë shumë kohë para themelimit të Qeverisë aktuale të Kosovës. Andaj, ToR duhet qartësisht të definoj konsumatorët që do të përfitojnë (p.sh. konsumatorët shtëpiak në Kosovë, ata në rajon, apo në rrjetin e gjërë evropian) dhe të ofroj garancionet e nevojshme që këto caqe do të realizohen.
5. **Alternativat karshi linjtit për qëllime të analizës së kostos më të ulët** - ToR e përcaktojnë qartazi projektin e linjtit si opsionin më të lirë. BB nuk ka mundësi të përcaktoj kësajsoj këtë projekt kur analizën e vetme financiare që e ka bërë ka qenë e fokusuar vetëm në projektin e linjtit. Nuk është bërë asnjë krahasim i këtij projekti me projektin për efijencë të energjisë, ko-gjenerim, importim të energjisë nga rrjeti rajonal/Shqipëria apo me ndonjë projekt që bazohet në energji të ripërtërishte apo të pastër. Rrjedhimisht, projekti bie në kundërshtim të drejtpërdrejt me kriteret III dhe IV të SFDC-së. Përfundimisht, BB duhet menjëherë të bëjë analizat e duhura financiare dhe ekonomike rreth projekteve të mësipërme dhe të njëjtat t'i vë në dispozicion të Panelit për shqyrtim dhe gjithësesi para se të lëshohet Kërkesa për oferta për kompanitë e parakualifikuara.
6. **Analiza e saktë e kostos përgjatë ciklit jetësor të projektit** – Analiza për koston përgjatë ciklit jetësor të termocentralit të bazuar në qymyr nuk përfshinë fare koston që rrjedh nga operimi i minierave të qymyrit, duke përfshirë këtu mbylljen e minierave dhe rikultivimin e tokës, si dhe koston që rezulton nga hiri fluturues. Për më tepër, analiza e ndjeshmërisë fare nuk merr në shqyrtim çmimin në rritje të qymyrit dhe për shfrytëzimin e qymyrit për prodhim të energjisë elektrike.
7. **Vlerësimi i saktë i pasojave mjedisore** – Vlerësimi i bërë për koston për ndikime mjedisore për termocentralin e bazuar në linjit nuk kanë marrë për bazë koston domethënëse që rezulton nga operimi i minierave apo nga emitimi i merkurit dhe plumbit, të cilat paraqesin shqetësim madhor për projekte nga linjiti. Për më tepër, ToR dhe analiza ekonomike nuk specifikojnë fare teknologjinë e nevojshme për reduktimin e Sox dhe Nox. Rrjedhimisht, projekti nuk përmbushë si duhet kriterin VI të SFDC-së.
8. **Problemi i humbjeve teknike dhe komerciale në rrjetin energjetik** – Masat e duhura për efijencë të energjisë dhe kursim të saj nuk janë zbatuar dhe nuk janë planifikuar të zbatohen në mënyrë që të adresohen problemet domethënëse të zvogëlimit të humbjeve teknike në rrjetin energjetik (17% e prodhimit bruto) dhe atyre komerciale (deri në 30% e konsumit bruto). Banka bazohet në zgjidhjen e këtij problemi përmes privatizimit të sektorit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike. Megjithatë, ToR nuk ofron detaje mbi atë se çfarë do të parasheh kontrata për këtë projekt në këtë mes dhe sa nga përfitimet energjetike përmes zbatimit të këtyre masave do të reflektojnë në përmirësimin e furnizimit me energji elektrike për vendin. Për më tepër, Banka Botërore nuk sugjeron zbatimin e ndonjë mase të re për efijencë apo kursim të energjisë, siç

---

është izolimi i shtëpive apo përdorimi i dritave floerescente. ToR aktual dëshon të siguroi që termocentralet aktuale janë të optimizuara sa i përket kursimit dhe efijcencës së energjisë, në përputhje me kriterin III të SFDCC-së.

9. **Përkrahja transparente dhe e prekshme për zhvillim të ulët të karbonit** –ToR përmend disa studime/aktivitete që kanë të bëjnë me burime energjetike me emetim të ulët karboni, siç është rasti me tarifën për energji nga uji dhe të erës. Megjithatë, ToR dëshon të ofroj të gjeturat, rezultatet e pritshme dhe çfarëdo progresi të arritur në këtë drejtim. Për më tepër, studimi i fizibilitetit për energji nga era dhe strategjia për karbon të ulët për Kosovën është dashur të bëhen përmes projektit pothuajse një dekadësh të Bankës botërore për asistencë Kosovës dhe do të duhej t'i ofroheshin Panelit vlerësues në këtë kohë. Duke dështuar për të prodhuar një studim me opsionet e energjisë së ripërtërishe për vendin që është premtuar në vitin 2006, BB ka dështuar të zbatoj kriterin II të SFDCC-së.

Duke u bazuar në gjetjet e renditura më lartë dhe duke pasur për bazë rëndësinë e madhe që ky projekt ka për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit, KIPRED, GAP dhe FIQ i bëjnë thirrje Bankës Botërore që të realizoj studimet e duhura për energji alternative në Kosovë, të analizoj në formë krahasimore çdo projekt të mundshëm energjetik në vend, të marrë për bazë dhe të propozoi projekte konkrete për të ndihmuar në fushën e efijcencës dhe kursimit të energjisë elektrike, si dhe në uljen e humbjeve teknike dhe komerciale të energjisë. Të gjitha këto duhet të bëhen para se të merret vendimi i Panelit vlerësues për kriteret.

Çdo vendim i Panelit në këtë fazë dhe në përputhje me termet e referencës së publikuar tani që kufizojnë fushëveprimin e tyre dhe janë shumë të paplota me informatat e nevojshme e të identifikuar më lartë, do të jetë vendim që reflekton fokusimin e BB-së në projektet e linjitet dhe që është në kundërshtim të plotë me Kornizën Strategjike për Zhvillim dhe Ndryshime Klimatike (SFDCC) të vet këtij institucioni.

**Krenar Gashi, KIPRED**

**Agron Demi, GAP**

**Ferdinand Nikolla, FIQ**

**Nezir Sinani, bashkë-autor i publikimit "Projektet Energjetike në Kosovë"**

20 shtator 2011, Prishtinë